

**Spiecapag Shqipëria Degë e Shoqërise së huaj**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

## **PËRMBAJTJA**

## **FAQE**

### PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5 – 22

**Spiecapag Shqipëria Degë e Shoqërisë së huaj**  
**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

*(Vlerat janë në Lek)*

**Pasqyra e Pozicionit Financiar**  
**më 31 dhjetor 2018**

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktivët afatgjata</b>			
Aktivët afatgjata materiale	6	1,240,387,394	1,368,613,949
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>1,240,387,394</b>	<b>1,368,613,949</b>
<b>Aktivët afatshkurtra</b>			
Inventarë	7	1,978,323,577	59,870,203
Llogari të arkëtueshme tregtare	8	-	3,864,204,116
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	9	-	83,711,400
Llogari të arkëtueshme të tjera	10	277,519,881	122,835,540
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	11	940,620,341	569,709,881
Mjetet monetare në arkë e në bankë	12	10,337,391,355	5,955,921,906
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>13,533,855,154</b>	<b>10,656,253,046</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>14,774,242,548</b>	<b>12,024,866,995</b>
<b>KAPITALI</b>			
Fitime të mbartura		3,562,266,501	1,559,343,984
Fitimi i ushtrimit		1,160,825,837	2,002,922,517
<b>Totali i kapitalit</b>	13	<b>4,723,092,338</b>	<b>3,562,266,501</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	14	11,600,755	186,409,275
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>11,600,755</b>	<b>186,409,275</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	15	132,744,636	353,245,269
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	16	5,182,737,178	2,459,071,331
Parapagimet e arkëtuara	17	4,645,801,517	5,436,256,280
Detyrime tatimore	18	28,266,124	2,618,339
Provizione	19	50,000,000	25,000,000
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>10,039,549,455</b>	<b>8,276,191,219</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>10,051,150,210</b>	<b>8,462,600,494</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>14,774,242,548</b>	<b>12,024,866,995</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Spiecapag Shqipëria Degë e Shoqërisë së huaj**  
**Pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Shenime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	34,495,934,530	29,356,050,566
Të ardhura të tjera	21	(3,451,514)	1,313,632
<b>Total të ardhura</b>		<b>34,492,483,016</b>	<b>29,357,364,198</b>
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	22	(31,834,447,906)	(25,753,396,374)
Shpenzime personeli	23	(97,964,704)	(113,562,496)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	24	(280,500,830)	(286,985,360)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(497,602,551)	(809,442,670)
<b>Total shpenzime</b>		<b>(32,710,515,991)</b>	<b>(26,963,386,900)</b>
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	26	73,477	70,530
Shpenzime të tjera financiare (neto)	27	(386,532,743)	9,203,765
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>1,395,507,759</b>	<b>2,403,251,593</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	28	<b>(234,681,922)</b>	<b>(400,329,076)</b>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(234,681,922)	(397,700,430)
Korrigjimi i tatim fitimit		-	(2,628,646)
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>1,160,825,837</b>	<b>2,002,922,517</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>1,160,825,837</b>	<b>2,002,922,517</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Spiecapag Albania**  
**Financial Statements as at and for the year ended December 31, 2018**  
*(All amounts are in ALL)*

**Statement of Changes in Equity**  
**For the year ended December 31, 2018**

	Subscribed capital	Retained earnings	Profit/Loss of the year	Total
Balance at 31 December 2016	-	-	-	-
Total comprehensive income for the year:				
Balance at 31 December 2017	-	1,559,343,984	2,002,922,517	3,562,266,501
Total comprehensive income for the year:				
Transfers in retained earnings		2,002,922,517	(2,002,922,517)	-
Balance at 31 December 2018	-	3,562,266,501	1,160,825,837	4,723,092,338

The financial statements have to be read in conjunction with the notes set out in pages 5-23, forming part of these financial statements.

The Financial Statements have been approved by the Management of Spiecapag Albania on \_\_\_\_\_ and have been signed on behalf for publication by:



**Z. Eric Eros Azika**  
 Head of Account Department

*[Handwritten signature]*  
**Z. Jean Paul Christian Chauvin**  
 Administrator

**Spiecapag Shqipëria**  
**Pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
<b>Fitimi para tatimit</b>	1,395,507,759	2,403,251,593
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	280,500,830	286,985,360
Provizione	25,000,000	25,000,000
Nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve fikse, neto nga fitimi kapital	(4,180,643)	(2,103,367)
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Rënie/(rritje) në inventar	(1,918,453,374)	619,573,866
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	3,793,231,177	422,989,516
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	2,119,322,555	(7,147,747,832)
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	(370,910,460)	(528,457,292)
Ndryshimi ne te ardhura te shtyra	(790,454,763)	(2,033,449,185)
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>	<b>4,529,563,081</b>	<b>(5,953,957,341)</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(161,027,083)	(305,144,276)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	12,933,451	48,587,526
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>	<b>(148,093,632)</b>	<b>(256,556,750)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	-	(184,862,253)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>	<b>-</b>	<b>(184,862,253)</b>
<b>Ndryshimi neto i mjeteve monetare</b>	<b>4,381,469,449</b>	<b>(6,395,376,344)</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës	5,955,921,906	12,351,298,250
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>12 10,337,391,355</b>	<b>5,955,921,906</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Spiecapag Shqipëria me formë ligjore Degë e Shoqërisë së huaj është regjistruar më 02/02/2016 në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare" dhe statuti i saj. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj dhe ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregtare".

Objektet kryesore të veprimtarisë së shoqërisë janë dizenjo, inxhinieri dhe ndërtim, asistencë teknike për impiante dhe makineri të rënda, ndërtimi dhe mirëmbajtje e impianteve përkohësisht përfshirë shërbime në terren. Shoqëria kryen çdo lloj transporti në Shqipëri, si edhe çdo aktivitet tjetër për nevojat e transportit apo nevoja të tjera në kuadër të Projektit TAP.

Administratorë të Shoqërisë janë Z. Jean Paul Christian Chauvin dhe Z. Olivier Thierry Marie Balloy. Adresa e Shoqërisë është Blv.Dëshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Qendra Tregtare, Kati i II, 1019, Tiranë dhe është e regjistruar si person juridik në Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj me L61402015T.

Në 31 dhjetor 2018 shoqëria ka patur 22 punonjës, (2017: 23 punonjës).

## **2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)**

### **2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

#### ***Adoptimi i IFRS 9 "Instrumentat Financiare"***

Shoqëria ka adoptuar IFRS 9, Instrumentat Financiar, nga 1 janar 2018. Kompania zgjodhi të mos rishikojë shifrat krahasuese dhe ka njohur çdo rregullim të vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve financiare në fitimet e mbartura të hapura që nga data e zbatimit fillestar të standardeve, më 1 janar 2018. Si rrjedhojë, kërkesat e rishikuara të SNRF 7, Instrumentat Financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese është zbatuar vetëm për periudhën aktuale. Dhënia e informacioneve shpjeguese për periudhën krahasuese përsërit ato informacione shpjeguese të bëra në vitin paraardhës.

#### ***Adoptimi i IFRS 15 "Të ardhura nga kontratat me klientët"***

Kompania njeh të ardhurat kur përmbush kushtet e performancës gjatë kohës vetëm nëse ajo mat në mënyrë të arsyeshme progresin kundrejt përmbushjes së plotë të kushteve të performancës. Kontrata me klientin konsiderohet si një kusht i vetëm performance.

Kompania njeh të ardhurat duke përdorur metodën e kostos plus marzhin kur kostoja është vlerësuar duke përdorur metodën input për njohjen e të ardhurave.

Kompania përjashton nga metoda input efektin e çdo malli apo shërbimi për të cilin ajo nuk transferon kontroll tek klienti.

Kompania konsideron kushtet e kontratës dhe ka përcaktuar çmimin e transaksionit bazuar në vlerën e kontratës. Çmimi i transaksionit është shuma korresponduese për të cilën pret të ketë të drejtë një njësi ekonomike në këmbim të transferimit tek klienti të mallrave apo shërbimeve të premtuara, duke përjashtuar shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta (për shembull, taksat mbi shitjen).

Deri më 31 dhjetor 2018 kompania ka njohur të ardhurat duke përdorur metodën e kostos plus marzhin. Si rezultat i këtij adoptimi të SNRF 15 nuk ka rezultuar me rregullime në pasqyrat financiare.

Standardet e ndryshuara në vijim bëhen efektive për Shoqërinë më 1 janar 2018, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material në Kompani:

- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesa me aksione" (lëshuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

## **2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)**

### **2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)**

- Ndryshimet në SNRF 4 - "Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve" (lëshuar më 12 shtator 2016 dhe efektive, varësisht nga qasja, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 për subjektet që zgjedhin të aplikojnë opsionin e përjashtimit të përkohshëm ose kur njësia ekonomike së pari aplikon SNRF 9 për njësitet ekonomike që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes).
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 (i publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- KIRFN 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe Konsiderata paraprake" (lëshuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNK 40 - "Transferet e Pronës së Investimit" (lëshuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

### **2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara**

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Kompania ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Kompania planifikon ti aplikojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës të marrë edhe financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave si qera operationale ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet që të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi në fjalë është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të marra me qira veç nga interesi për detyrimet e qirasë financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. SNRF 16 në thelb ka të njëjtat kërkesa me SNK 17 për trajtimin kontabël të qirave në këndvështrimin e qiradhënësit. Ndaj, një qiradhënësi vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera të zakonshme ose qera financiare dhe të bëjë llogaritjet bazuar në llojin e qerasë.

Shoqëria ka vendosur zbatimin e standardit nga data e saj e adoptimit të detyrueshëm, data 1 janar 2019 duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, pa riparaqitje të shifrave krahasuese.

Ndryshimet që mund të jenë relevante për Shoqërinë, por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të saj, janë paraqitur më poshtë:

- KIFRN 23 "Paqartësi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat" (në fuqi më 1 janar 2019).
- Përmirësimet vjetore (cikli 2015-2017) (i detyrueshëm për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNRF 9 "Tiparet e Parapagimit me Kompensim Negativ" (në fuqi më 1 Janar 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimet e planit, kufizimet dhe vendbanimet" (të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" (e detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).

## **3. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **3.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).



### **3. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

#### **3.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimit Financiar.

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike

#### **3.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

#### **3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### **3.5. Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, në datën e Pasqyrës së Pozicionit Financiar, ashtu si dhe të ardhurat dhe shpenzimet e të kryera gjatë periudhës kontabël.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe janë të bazuara në eksperiencat e mëparshme dhe në faktorë të tjerë përfshirë vlerësimet për ngjarjet e ardhshme që konsiderohen të jenë të arsyeshme duke marrë në konsideratë rrethanat aktuale. Drejtimi përdor vlerësimet dhe supozimet për kaq kohë sa periudhat e ardhshme ndikohen. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar ndryshime materiale në vlerat aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

##### **3.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### **4. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### **4.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
EUR/Lek	123.42	132.95
USD/ Lek	107.82	111.10

#### 4.2. Instrumentat financiarë

*Politika të aplikueshme nga 1 janar 2018*

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

**Instrumentat financiare – njohja fillestare.** Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes.** Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit.** Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrë se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

**Aktivitet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare.** Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 4 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

**Aktivitet financiare – pakësimi i vlerës.** Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen

#### **4. Politikat kontabël (vazhdim)**

##### **4.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

**Aktivet financiare - çregjistrimi.** Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar (“aktivi fillestar”), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t’ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësisive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

**Detyrimet financiare – kategorite e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

**Detyrimet financiare – çregjistrimi.** Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

**Kompensimi i instrumenteve financiare.** Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshkohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

##### *Politika të aplikueshme para 1 janar 2018*

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

#### **4. Politikat kontabël (vazhdim)**

##### **4.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

###### *Politika të aplikueshme para 1 janar 2018 (vazhdim)*

Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

###### *Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

###### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

###### *Llogaritë e pagueshme*

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

###### *Huatë*

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së koston së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skonton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

###### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përfaqësohen me vlerat e tyre kontabël.

*(Vlerat janë në Lek)*

#### **4. Politikat kontabël (vazhdim)**

##### **4.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

###### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

###### *Kapitali*

Kapitali njihet me vlerën nominale.

###### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### **4.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Kostot e përpunimit të inventarit përfshijnë kostot e lidhura direkt me njësitë e prodhimit, si puna direkte. Ato përfshijnë gjithashtu një shpërndarje sistematike të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit, fikse dhe variabël, të cilat kryhen gjatë përpunimit të materialeve në produkte të përfunduara.

Shpenzimet e përgjithshme fikse të prodhimit janë ato kosto indirekte të prodhimit që mbeten relativisht konstante pavarësisht vëllimit të prodhimit si amortizimi i ndërtesës dhe i pajisjeve të fabrikës dhe kostot e mirëmbajtjes, dhe kostot e drejtimit dhe administrimit të fabrikës.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

##### **4.4. Aktive afatgjata materiale**

###### *i. Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitet. Kosto e aktivitet të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivitet në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Shpenzimet kapitale të lidhura me aktivitet e ndërtuara vetë kapitalizohen në llogarinë “Ndërtim në proces” dhe transferohet në kategorinë e caktuar të aktiveve kur prodhimi ka përfunduar, kur është aplikuar kategoria repsektive e amortizimit.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.

**4. Politikat Kontabël (vazhdim)****4.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të akteveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të akteveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

*ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të akteveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të akteveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*iii. Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur në bazë të metodës së amortizimit të vlerës së mbetur, përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit afatgjatë material, që fillon që nga dita e parë e muajit pas muajit të blerjes. Aktivitet afatgjatë material në qira amortizohet në bazë të kohës më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

<b>Kategoria e aktiveve</b>	<b>Metoda e Amortizimit</b>	<b>Norma e Amortizimit</b>
Ndërtesa dhe instalime	Vlera e mbetur	5 %
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mobilje e orendi	Vlera e mbetur	20 %

Toka nuk amortizohet.

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të akteveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**4.5. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

**4.6. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

**4. Politikat Kontabël (vazhdim)****4.7. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar ose për tu arkëtuar mbi fitimin apo humbjen e tatuesheme të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

**4.8. Përfitimet e punëmarrësve**

Shoqëria paguan kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, përfshirë edhe përfitimet e pensionit të punonjësve në përputhje me legjistacionin shqiptar. Autoritetet fiskale janë përgjegjëse për përfshirjen nivelin minimal ligjor të pensioneve në juridiksionin e caktuar sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

**4.9. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i Shoqërisë dhe Manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

**4.10. Provizione**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

**4.11. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

## 5. Gjykime dhe vlerësime të kontabilitetit

### *Vlerësimi i modelit të biznesit*

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi. Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes.

Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Gjatë kalimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje aktiviteti financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezulton nga shkeljet e kritereve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore. Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

### *Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")*

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesit kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

### *Matjet humbjeve të parashikuara të kredise*

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.



**Spiecapag Shqipëria**  
**Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në Lek)

**6. Aktive Afatgjata Materiale**

Aktivitet Afatgjata Materiale më 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	<b>Ndërtesa</b>	<b>Makineri dhe Pajisje</b>	<b>Mjete transporti</b>	<b>Pajisje informatike</b>	<b>Mobilje e pajisje zyre</b>	<b>Ne proces</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>							
Gjendja më 1 janar 2017	111,530,610	312,602,264	497,838,419	22,676,367	11,985,448	472,305,377	<b>1,428,938,485</b>
Shtesa	58,494,586	190,999,474	54,421,727	973,407	255,082	-	<b>305,144,276</b>
Transferime	472,305,377	-	-	-	-	(472,305,377)	-
Pakësime	-	(41,170,015)	(7,417,511)	-	-	-	<b>(48,587,526)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>642,330,573</b>	<b>462,431,723</b>	<b>544,842,635</b>	<b>23,649,774</b>	<b>12,240,530</b>	-	<b>1,685,495,235</b>
Shtesa	59,512,920	95,187,628	-	476,369	5,850,166	-	<b>161,027,083</b>
Transferime	-	-	-	-	-	-	-
Pakësime	-	-	(12,865,784)	(67,667)	-	-	<b>(12,933,451)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>701,843,493</b>	<b>557,619,351</b>	<b>531,976,851</b>	<b>24,058,476</b>	<b>18,090,696</b>	-	<b>1,833,588,867</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>							
Gjendja më 1 janar 2017	1,867,082	9,124,813	17,417,772	2,431,899	1,157,727	-	<b>31,999,293</b>
Amortizimi i vitit	107,383,946	71,366,128	100,893,497	5,142,234	2,199,555	-	<b>286,985,360</b>
Kthim amortizimi	-	(1,389,674)	(713,693)	-	-	-	<b>(2,103,367)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>109,251,028</b>	<b>79,101,267</b>	<b>117,597,576</b>	<b>7,574,133</b>	<b>3,357,282</b>	-	<b>316,881,286</b>
Amortizimi i vitit	107,111,850	82,129,553	85,235,615	4,052,157	1,971,655	-	<b>280,500,830</b>
Pakësime	-	-	(4,144,732)	(35,911)	-	-	<b>(4,180,643)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>216,362,878</b>	<b>161,230,820</b>	<b>198,688,459</b>	<b>11,590,379</b>	<b>5,328,937</b>	-	<b>593,201,473</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>							
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>533,079,545</b>	<b>383,330,456</b>	<b>427,245,059</b>	<b>16,075,641</b>	<b>8,883,248</b>	-	<b>1,368,613,949</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>485,480,615</b>	<b>396,388,531</b>	<b>333,288,392</b>	<b>12,468,097</b>	<b>12,761,759</b>	-	<b>1,240,387,394</b>

**Spiecapag Shqipëria**  
**Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në Lek)

**7. Inventarë**

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Lëndë ndihmëse dhe te konsumueshme	65,313,572	59,870,203
Punime ne proces te pa certifikuara	1,913,010,005	-
	<u><b>1,978,323,577</b></u>	<u><b>59,870,203</b></u>

**8. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Klientë	-	3,864,204,116
	<u>-</u>	<u><b>3,864,204,116</b></u>

**9. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Spiecapag Transadriatica kërkesa të arkëtueshme tregtare	-	83,711,400
	<u>-</u>	<u><b>83,711,400</b></u>

**10. Llogari të arkëtueshme të tjera**

Llogaritë e arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
TVSH e kreditueshme	-	5,501,039
TVSH per tu regulluar	739,048	307,978
Detyrime doganore	4,822	1,275,202
Garanci te paguara	1,078,467	1,037,010
Të tjera të arkëtueshme	2,170,929	1,581,590
Tatim fitim I rimbursueshëm	273,526,615	113,132,721
	<u><b>277,519,881</b></u>	<u><b>122,835,540</b></u>

**Spiecapag Shqipëria**  
**Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në Lek)

**11. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Parapagime për furnizime	901,359,884	499,415,250
Shpenzime të shtyra për prime sigurimi	39,260,457	70,294,631
	<u><b>940,620,341</b></u>	<u><b>569,709,881</b></u>

**12. Mjete monetare në arkë dhe në bankë**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Likuiditete në bankë	10,324,801,699	5,948,333,898
Likuiditete në arkë	12,589,656	7,588,008
	<u><b>10,337,391,355</b></u>	<u><b>5,955,921,906</b></u>

**13. Kapitali**

Shoqëria është degë e një shoqërie të huaj dhe nuk ka kapital të regjistruar.

Fitimet e mbartura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë: 3,562,266,512 Lekë.

Fitimi i ushtrimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 është: 1,160,825,837 Lekë.

**14. Llogari të pagueshme tregtare afatgjata**

Hua afatgjata nga ortakët më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Llogari të pagueshme tregtare	11,600,755	186,409,275
	<u><b>11,600,755</b></u>	<u><b>186,409,275</b></u>

**15. Llogari të pagueshme tregtare afatshkurta**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Llogari të pagueshme tregtare	54,928,135	241,002,915
Furnitorë për fatura të pambërritura	77,816,501	112,242,354
	<u><b>132,744,636</b></u>	<u><b>353,245,269</b></u>

**Spiecapag Shqipëria**  
**Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në Lek)

**16. Llogari të pagueshme nga palët e lidhura**

Llogari të pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Spiecapag France	1,953,090,054	744,016,460
Spiecapag Transadriatica	3,229,647,124	1,715,054,871
	<u><b>5,182,737,178</b></u>	<u><b>2,459,071,331</b></u>

**17. Parapagime të arkëtuara**

Parapagimet e arkëtuara më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Parapagime nga klientë	-	3,209,898,002
Të ardhura të shtyra	4,645,801,517	2,226,358,278
	<u><b>4,645,801,517</b></u>	<u><b>5,436,256,280</b></u>

**18. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	733,327	861,214
Detyrime për tatim page	877,542	1,402,965
TVSH për t'u paguar	25,882,274	-
Detyrime për tatim në burim	772,981	354,160
	<u><b>28,266,124</b></u>	<u><b>2,618,330</b></u>

**19. Provizione**

Provizionet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
<b>Gjendja në fillim</b>	25,000,000	
Shtesat e periudhës	25,000,000	25,000,000
<b>Gjendja në fund</b>	<u><b>50,000,000</b></u>	<u><b>25,000,000</b></u>

**Spiecapag Shqipëria**  
**Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në Lek)

**20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	34,495,934,530	29,356,050,566
	<b>34,495,934,530</b>	<b>29,356,050,566</b>

**Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:**

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
<b>Rakordimi i të ardhurave me FDP-në</b>		
Qarkullim i tatueshëm	35,102,273,004	<b>27,323,331,202</b>
Zbriten parapagimet dhe të ardhurat e shtyra	790,454,763	2,033,449,183
Zbriten vlera e kthimit të pjesëve dhe pajisjeve paraqitur për neto	(29,971,415)	(729,819)
Zbriten vlera e kthimit të pajisjeve të marra me Qera	(1,362,587,515)	-
Korrigjohet për koston aktiveve të shitura e paraqitur neto	(7,685,821)	-
<b>Shuma e qarkullimit e korrektuar</b>	<b>34,492,483,016</b>	<b>29,356,050,566</b>
<b>Diferenca</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Të ardhura nga këmbimet valutore	628,232,685	346,712,899
Të ardhura nga interesat	73,477	41,234
Të ardhura të tjera financiare	535,793	
<b>Total të ardhura deklaruar në FDP-në e Tatim Fitimit</b>	<b>35,121,324,971</b>	<b>29,702,804,699</b>

**21. Të ardhura të tjera**

Të ardhurat të tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
Të ardhura nga shitja e aseteve fikse	(3,451,514)	1,313,632
	<b>(3,451,514)</b>	<b>1,313,632</b>

***Dalja jashte perdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale***

Te ardhura nga shitja e AAM	4,234,307	8,017,450
Shpenzime nga shitja e AAM	(7,685,821)	(6,703,818)
Te ardhura nga shitja e AAM	-	39,780,341
Shpenzime nga shitja e AAM	-	(39,780,341)
<b>Rezultati Neto nga shitja e AAM</b>	<b>(3,451,514)</b>	<b>1,313,632</b>

**Spiecapag Shqipëria**  
**Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në Lek)

**22. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b><u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u></b>	<b><u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u></b>
Nenkontraktore	24,731,046,862	19,707,280,141
Qera Pajsje	5,013,533,544	2,842,743,619
Sherbime teknike dhe te manxhimit	1,251,879,762	1,089,493,288
Pjesë këmbimi	483,603,898	646,080,417
Lëndë ndihmëse dhe te konsumueshme	175,676,840	311,590,049
Transport	120,348,831	287,961,304
Mirembajtje dhe riparime	85,541,860	50,264,380
Lëndë djegëse	2,787,724	5,798,100
Zbriten vlera e kthimit te pjeseve dhe pajisjeve paraqitur per neto	(29,971,415)	(7,462,446)
Qera kampi	-	819,647,522
	<b><u>31,834,447,906</u></b>	<b><u>25,753,396,374</u></b>

**23. Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b><u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u></b>	<b><u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u></b>
Shpenzime për paga	91,860,427	107,918,520
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	6,104,277	5,643,976
	<b><u>97,964,704</u></b>	<b><u>113,562,496</u></b>

**24. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi**

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b><u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u></b>	<b><u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u></b>
Shpenzime amortizimi	280,500,830	286,985,360
	<b><u>280,500,830</u></b>	<b><u>286,985,360</u></b>

**Spiecapag Shqipëria****Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë në Lek)***25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
Kompensime	134,777,543	197,371,323
Sigurime	80,894,871	70,594,999
Blerje energji, avull, ujë karburant	54,096,231	17,915,845
Te tjera shpenzime per personelin	48,633,268	48,692,130
Qera	34,755,903	52,460,926
Provizione per reziqe	25,000,000	25,000,000
Shpenzime per granci	23,344,530	38,020,222
Shpenzime Telefon&Internet	22,052,207	19,640,682
Shpenzime per zyrat	18,489,802	63,144,618
Shpenzime ligjore e konsulenca	16,496,483	46,712,333
Te tjera shpenzime	15,567,835	7,903,093
Mirëmbajtje dhe riparime	10,662,274	79,909,482
Tatime & taksa	8,362,718	113,054,292
Komisione dhe tarifa bankare	1,880,639	19,813,709
Gjoha e demshperblime	1,329,279	7,213,485
Udhetime e dieta	831,165	702,757
Sponsorizime e donacione	427,803	-
Shpenzime te ndryshme administrative	-	1,292,774
	<b>497,602,551</b>	<b>809,442,670</b>

**26. Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)**

Shpenzimet e interesit (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
Te ardhura nga interesat	73,477	70,530
	<b>73,477</b>	<b>70,530</b>

**Spiecapag Shqipëria**  
**Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në Lek)

**27. Shpenzime të tjera financiare (neto)**

Shpenzimet e tjera financiare (neto) paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Te ardhura te tjera financiare	535,793	-
Humbje nga kembimet valutote	(1,015,301,221)	(672,872,461)
Te ardhura nga kembimet valutore	628,232,685	682,076,226
	<u><b>(386,532,743)</b></u>	<u><b>9,203,765</b></u>

**28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>1,395,507,759</b>	<b>2,403,251,593</b>
Shpenzime të panjohura	<u>169,038,387</u>	<u>248,084,607</u>
Shpenzime udhëtimi	831,165	697,247
Gjoba dhe penalitete	1,329,279	15,115,537
Shpenzime pa dokumenta te regullt tatimore	7,100,400	9,900,500
Kompesim per demshperblime	134,777,543	197,371,323
Provizion	25,000,000	25,000,000
<b>Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)</b>	<b>1,564,546,146</b>	<b>2,651,336,200</b>
<b>Rezultati Fiskal</b>	<b>1,564,546,146</b>	<b>2,651,336,200</b>
<b>Tatim fitimi 15%</b>	234,681,922	397,700,430
<b>Zbritje nga tatim fitimi</b>	-	2,628,646
	<u><b>1,160,825,837</b></u>	<u><b>2,002,922,517</b></u>

**29. Palët e lidhura**

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme me palët e lidhura paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>		<u>31 dhjetor 2017</u>	
	<u>Të arkëtueshme</u>	<u>Të pagueshme</u>	<u>Të arkëtueshme</u>	<u>Të pagueshme</u>
Spiecapag France	-	1,953,090,054		744,016,460
Spiecapag Transadriatica	-	3,229,647,124	83,711,400	1,715,054,871
	-	<u><b>5,182,737,178</b></u>	<u><b>83,711,400</b></u>	<u><b>2,459,071,331</b></u>

**30. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.